

Примено Република	13.01.2023		
Сл. единица Vlera (Zg.)	08	206/1	
Вредност Vlera			



Република Северна Македонија
ОПЕРАТИВНО-ТЕХНИЧКА АГЕНЦИЈА



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISE SE VERIUT
Оперативно-техничка агенција
Agjencia teknike-operative
Бр./Nr. 08-20/2
13.01.2023 год./viti
СКОПЈЕ- SHKUP

Republika e Maqedonisë së Veriut
AGJENCIA-TEKNIKE OPERATIVE



Republic of North Macedonia
OPERATIONAL-TECHNICAL AGENCY

До:
СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
Бул. „11 Октомври“ бр.10
1000 Скопје, Република Северна Македонија

За: г-дин Talat Xhaferi, претседател

Предмет: Годишен извештај за работењето на
Оперативно-техничката агенција за 2022 година
- доставува -

Почитуван претседател на Собранието на
Република Северна Македонија,

Во прилог на овој допис, а врз основа на член 7 од
Законот за Оперативно-техничка агенција („Службен
весник на Република Македонија“ бр. 71/18 и „Службен
весник на Република Северна Македонија“ бр. 98/19) до
Собранието на Република Северна Македонија го
доставувам за разгледување Годишниот извештај за
работењето на ОТА за 2022 година заведен под број 08-
20/1 од 12.01.2023 година.

За сите потребни прашања и образложенија
останувам на располагање.

Прилог:
Годишен извештај за работењето на ОТА за 2022
година број 08-20/1 од 12.01.2023 година

Со почит,

Drejtuar:
KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SE VERIUT
Bul. „11 Tetor“ nr.10
1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Për: z. Talat Xhaferi, kryetarë

Lënda: Raport vjetorë për punën e Agjensisë Teknike
Operative për vitin 2022
- dorzon -

I nderuar kryetarë i Kuvendit të Republikës së
Maqedonisë së Veriut

Në shtojcë të kësaj shkrese, ndërsa në bazë të nenit 7
të Ligjit për Agjensinë Teknike Operative („Gazeta zyrtare e
Republikës së Maqedonisë“ nr. 71/18 dhe „Gazeta zyrtare e
Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 98/19) në Kuvendin
e republikës së Maqedonisë së Veriut e dorëzoj për shqyrtim
Raportin vjetorë për punën e ATO-s për vitin 2022 i arkivuar
me numër 08-20/1 nga 12.01.2023.

Për të gjitha pyetjet dhe arsyetimet jam në dispozicion.

Shtojcë:
Raportin vjetorë për punën e ATO-s për vitin 2022 i
arkivuar me numër 08-20/1 nga 12.01.2023

Me respekt,

ОПЕРАТИВНО-ТЕХНИЧКА АГЕНЦИЈА/
AGJENCIA TEKNIKE-OPERATIVE
ДИРЕКТОР/DREJTOR,
Зоран Ангеловски



Изработено во два (2) примерока и доставено до:
Përpiluar në (2) ekzemplarë, dhe dorëzuar:
- писарница на ОТА/Sekretarisë së ATO-s
- Собрание на РСМ/Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut

RAPORT VJETOR PËR VITIN 2022
PËR
PUNËN E AGJENCISË TEKNIKE OPERATIVE SHKUP

Shkup,
Janar 2023

Në bazë të nenit 7 të Ligjit për Agjencinë Teknike -Operative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 71/18 dhe “Gazetës zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 98/19 – më tutje në tekstin: LATO), drejtori i Agjencisë Teknike-Operative Shkup (në tekstin e më tutjeshëm:ATO), e miratoi raportin në vijim:

RAPORT VJETOR

PËR PUNËN E AGJENCISË TEKNIKE-OPERATIVE SHKUP PËR VITIN 2022

I. HYRJE

Agjencia Teknike-Operative është organ i pavarur shtetëror, i themeluar me Ligjin për Agjencinë Teknike-Operative, me të cilin ligj krahas themelimit të ATO-s, rregullohen edhe kompetencat, udhëheqja, të drejtat dhe obligimet nga marrëdhënia e punës së të punësuarve në ATO-s, mbikëqyrja profesionale dhe financimi i ATO-s.

Në pajtim me dispozitat ligjore, drejtori i ATO-s në kuadër të afatit të përcaktuar ligjor e dorëzon për shqyrtim në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut këtë raport vjetor për punën e ATO-s për vitin 2022.

II. NUMRI I KOMUNIKIMEVE TË AKTIVIZUARA PËR NEVOJAT E ORGANEVE TË AUTORIZUARA

Gjatë vitit 2022, për nevojat e organeve të autorizuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ATO ndërmjetësoi teknikisht në:

- 369 aktivizime të reja të masës për ndjekje të komunikimeve dhe
- 328 vazhdime të masës ndjekje të komunikimeve.

III. NUMRI I KOMUNIKIMEVE TË AKTIVIZUARA PËR ÇDO ORGAN TË AUTORIZUAR VEÇMAS

Nga numri i cekur total prej 369 aktivizimeve të masës për ndjekje të komunikimeve me ndërmjetësim teknik të ATO-së në vitin 2022, 278 aktivizime të masës ndjekje të komunikimeve ishin për nevojat e MPB-së.

Nga 328 vazhdimet e cekura të masës ndjekje të komunikimeve me ndërmjetësim teknik të ATO-së në vitin 2022, 149 vazhdime të masës ndjekje të komunikimeve ishin për nevojat e MPB-së.

IV. GJENDJA DHE KONSTATIMET GJATË MBIKËQYRJEVE TË KRYERA PROFESIONALE NGA ATO MBI PUNËN E OPERATORËVE

Gjatë vitit 2022 në kuadër të kompetencave të saj ligjore, e për shkak të kontrollit të harmonizimit të kushteve teknike dhe masave dhe standardeve të aplikuara gjatë ndjekjes së komunikimeve elektronike, Agjencia Teknike-Operative në vazhdimësi realizoi kontroll të planifikuar, të rregullt dhe të jashtëzakonshëm në punën e operatorëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në pajtim me Planin për kryerje të mbikëqyrjeve mbi punën e operatorëve, gjatë vitit 2022 nga Komisioni kompetent i ATO-s, janë realizuar pesë mbikëqyrje të rregullta profesionale te operatorët e telekomunikimit: Telekom i Maqedonis, A1 Makedonia, Neotel, Tele-kabell dhe MTel.

Objekti i mbikëqyrjes u caktua me qëllim përcaktimin e gjendjeve të operatorët, përdorimin e pajisjes teknike dhe përçuesve komunikues për lidhjen e ATO-s dhe operatorët, si dhe planet për zhvillim dhe aplikim të teknologjive të reja që do të kenë ndikim mbi sigurimin e kushteve të domosdoshme me të cilat mundësohet ndjekja e komunikimeve me ndërmjetësim të ATO-së, më saktësisht:

- Kontrolli i parametrave dhe kontrolli në elementet e rrjetit me LI funksionalitet, si obligim në pajtim me *Rregulloren për mënyrën e veprimit të operatorëve gjatë zbatimit të masave për ndjekje të komunikimeve dhe mënyrën e kryerjes së mbikëqyrjes profesionale nga ATO* (neni 14 paragrafi 3);
- Kontrolli në procesverbalet nga kontrollet e kryera në pajtim me procedurat e sigurisë për mënyrat e mirëmbajtjes teknike dhe mënjanimin e defekteve të lidhura me elementet e rrjetit me LI funksionalitetin – obligim në pajtim me *Rregulloren për mënyrën e veprimit të operatorëve gjatë zbatimit të masave për ndjekje të komunikimeve dhe mënyrën e kryerjes së mbikëqyrjes profesionale nga ATO* (neni 16 paragrafi 5);
- Kontrolli i dokumenteve sistemore (skedarë log alarm) që krijohen për nevojat e mirëmbajtjes teknike dhe mënjanimin e defekteve të sistemeve me LI funksionalitetin - obligim në pajtim me *Rregulloren për mënyrën e veprimit të operatorëve gjatë zbatimit të masave për ndjekje të komunikimeve dhe mënyrën e kryerjes së mbikëqyrjes profesionale nga ATO* (neni 29 paragrafi 2);
- Kontroll në raportet me shkrim nga kontrollet e brendshme për funksionimin, efektet dhe dobësitë në sigurinë e sistemeve të informacionit - obligim në pajtim me *Rregulloren për masat dhe standardet për siguri të informacionit të cilët janë të detyruar që t'i aplikojnë operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike publike dhe/ose shërbimeve në lidhje me obligimet për zbatim të masave për ndjekje të komunikimeve* (neni 4);
- Informimi për shërbime të reja të planifikuara si dhe ndryshimet në strukturën e rrjetit që do t'i afektojnë elementet e rrjetit me LI funksionalitet.

Gjithashtu, realizimi i aktiviteteve të rregullta që u zhvillua gjatë implementimit të zgjidhjeve teknike, u mundësuan përfaqësuesve kompetentë nga ATO kontroll sistemor të gjendjeve të elementet e rrjetit që janë pjesë e procesit të ndjekjes së komunikimeve të operatorët, duke kryer kontroll të drejtpërdrejtë në infrastrukturën e disponueshme, përmbushjen e kushteve teknike dhe masat e aplikuar në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore, me ç'rast janë dorëzuar kërkesa të operatorët për veprim dhe mundësim të kushteve teknike që i imponon progresi teknologjik në fushën e telekomunikimeve dhe ligjeve referente.

V. NUMRI I PROCEDURAVE TË ZBATUARA DISIPLINORE PËR TË PUNËSUARIT NË ATO

Gjatë vitit 2022 në ATO nuk u zbatuan procedura disiplinore

VI. PUNA FINANCIARE E ATO-s

Financimi i Agjencisë Teknike Operative

Në pajtim me nenin 33 të Ligjit për Agjencinë Teknike Operative (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 71/18 dhe “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 98/19 më tutje në tekstin: LATO, sigurohen:

- nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut (a.q. shpenzime nga buxheti themelor) dhe

- nga kompensimet e Agjencisë për Komunikime Elektronike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pajtim me nenin 29-a të Ligjit për komunikime elektrike (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 39/14, 188/14, 44/15, 193/15, 11/18, 21/18 dhe “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 98/19, 153/19 dhe 92/21 më tutje në tekstin: LKE), në bazë të planit financiar vjetor të miratuar paraprakisht të ATO-s nga Komisioni për Mbikëqyrje të Zbatimit të Masave për Ndjekje të Komunikimeve i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (a.q. shpenzime nga aktivitetet vetëfinancuese).

Buxheti i Agjencisë Teknike Operative për vitin 2022

Gjatë vitit buxhetor 2022 në aspekt të caktimit të Buxhetit të ATO janë miratuar aktet relevante vijuese:

1. Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 287/2021),
2. Ndryshimi dhe plotësimi i Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 164/2022),
3. Miratim për zgjerim nga Ministria e Financave nr. 08-8168/2 nga 16.08.2022 dhe
4. Vendim për rishpërndarje të mjeteve ndërmjet shfrytëzuesve buxhetorë të pushtetit qendror dhe ndërmjet fondeve (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 232/2022).


Pasqyra e miratimit, ndryshimeve dhe plotësimeve të Buxhetit të ATO-s gjatë vitit 2022 është paraqitur në Tabelën 1.

Struktura e Buxhetit final për vitin 2022 sipas llogarive është paraqitur në Grafikon 1.

STRUKTURA E BUXHETIT	LLOGARIA	BUXHETI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR 2022	NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I BUXHETIT TË RMV-SË PËR 2022	MIRATIM PËR ZGJERIM NGA MINISTRIA E FINANCEVE NR. 08-8168/2 nga 16.08.2022	VENDIM PËR RISHPËRNDARJE TË MJETEVE NDËRMJET SHFRYTËZUESVE BUXHETORË TË PUSHTETIT QENDROR NDËRMJET FONDEVE	BUXHETI FINAL I ATO PËR VITIN 2022
Shpenzime të Buxhetit themelor	630	261,825,000.00	- 44,733,000.00	0.00	-1,160,000.00	215,932,000.00
Shpenzime nga aktivitetet vetëfinancuese	787	82,140,000.00	20,000,000.00	16,010,000.00	0.00	118,150,000.00
Shpenzime nga donacione	785	0.00	14,152,000.00	0.00	0.00	14,152,000.00
Gjithsej shpenzime		343,965,000.00	-10,581,000.00	16,010,000.00	-1,160,000.00	348,234,000.00

Tabela 1. Pasqyra e miratimit, ndryshimeve dhe plotësimeve të Buxhetit të ATO në vitin 2022

Grafiku 1. Struktura e buxhetit final i ATO-s për vitin 2022 sipas llogarive



Shpenzime nga Buxheti Themelor

Shpenzimet nga Buxheti Themelor gjatë vitit 2022 u zvogëluan për shumë të përgjithshme prej 45,893, 000, 00 denarë në pjesën e shpenzimeve kapitale.

Shpenzime nga aktivitetet vetëfinancuese

Shuma në fillim të vitit buxhetor 2022, e cila gjatë vitit ristrukturohet në pajtim me pagesat reale nga AKE dhe mjetet tjera nga viti buxhetor 2021 u rrit për 36.010.000,00 denarë dhe i formuar në shumën e përgjithshme të disponueshme prej 118.150.000,00 denarë.

Projeksionet për realizim të shpenzimeve nga aktivitetet vetëfinancuese në vitin 2022 janë planifikuar me Planin financiar vjetor për vitin 2022 të Agjencisë Teknike Operative (ndryshim 01), të cilët në pajtim me ligjin janë miratuar nga Komisioni për Mbikëqyrje të Zbatimit të Masave për Ndjekje të Komunikimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Shpenzime të donacioneve

Për nevojat e zhvillimit dhe implementimit të zgjidhjes adekuate ligjore, të sigurt dhe efikase për avancimin dhe digjitalizimin e procesit për zbatim të masës për ndjekje të komunikimeve elektronike, në bazë të donacionit të Agjencisë për Komunikime Elektronike (AKE) në llogari

të veçantë (donacion) të Buxhetit të ATO-s për dedikimin e cekur u paraparë shuma prej 14,152,000,00 denarë.

Realizimi i buxhetit të ATO-s për vitin 2022

Nga gjithsej mjetet e miratuara në shumë prej 348,234,000,00 në Buxhetin e ATO-s për vitin 2022 u realizuan mjete në shumë të përgjithshme prej 306,364,481.00 denarë, përkatësisht shkalla e përgjithshme e realizimit është 87,98%

- nga shpenzimet e Buxhetit themelor në vitin 2022 u realizuan 215.534.211,00 denarë, që paraqet 99,82% të shumës së përgjithshme të mjeteve të miratuara;
- nga shpenzimet nga aktivitetet vetëfinancuese, në vitin 2022 janë realizuar 76.678.604,00 denarë, që paraqet 64,90% nga shuma e përgjithshme e mjeteve të miratuara. Pjesa e porealizuar e mjeteve në pajtim me Ligjin për buxhetet në fund të vitit fiskal transferohen në vitin e ardhshëm 2023;
- nga shpenzimet nga donacioni janë realizuar 14.151.666,00 denarë, që paraqet 100% nga shuma e përgjithshme e paraparë.


Realizimi i mjeteve të ATO për vitin 2022 të shpërndara në zëra është siç është paraqitur në Tabelën 2.

Zëri	Nënzëri	Shuma të realizuara në denarë
40- rroga dhe kompensime	401	22,435,280.00
	402	10,665,189.00
	404	225,000.00
42 – Mallra dhe shërbime	420	422,920.00
	421	3,447,960.00
	423	168,261.00
	424	34,516,391.00
	425	8,914,666.00
	426	596,274.00
46 – Subvencione dhe transferime	464	29,943.00
48-Shpenzime kapitale	480	25,950,552.00
	481	1,392,302.00
	485	197,599,743.00
GJITHSEJ		306,364,481.00

Tabela 2. Realizimi sipas zërave të ATO për vitin 2022

Në pajtim me të dhënat për realizim, pjesa më e madhe e Buxhetit, përkatësisht 73% e Buxhetit të miratuar të përgjithshëm të ATO-s për vitin 2022 është realizuar për shpenzime kapitale, ndërsa pjesa tjetër e mjeteve është realizuar për shpenzimet siç është paraqitur në tabelën dhe grafikun.

Grafiku 2. Realizimi i Buxhetit të ATO-s për vitin 2022



VII. PUBLIKIMI

Ky Raport vjetor për punën e ATO-s për vitin 2022, në afatin e paraparë ligjor dorëzohet për shqyrtim në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe i njëjti publikohet në vend të dukshëm në faqen e internetit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut

**AGJENCIA TEKNIKE-OPERATIVE
DREJTOR**

Zoran Angellovski